



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14640 Prot

Lezhë, më 30 / 08 /2022

VENDIM

Nr. 97, Datë 29 . 08 .2022

**“PËR  
MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIMIN E  
INTERESAVE TË KREDISË PËR VITIN 2022”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.453 datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Lezhë nr.5, datë 28.01.2020 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit dhe programeve sociale të strehimit”, shkresës nr.18627 prot., datë 17.10.2019 “Mbi projektin për subvencionimin e interesave të kredisë” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shkresës 13655 prot., datë 04.08.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Relacionin e Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social nr.14372/1 prot., datë 19.08.2022, “Relacion përmbledhes për programin e subvencionimit të interesave të kredive, Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Lezhë nr.14372/1 prot., datë 22.08.2022, “Për miratimin e listës së familjeve përfituese për programin e subvencionimit të kredive për vitin 2022”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**VENDOSI:**

1. Të miratoje listën e familjeve që përfitojnë subvencionim të interesave të kredisë për vitin 2022 me numër rendor 62, dhe listën rezervë me numër rendor 4, sipas Lidhjes nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

K.B.  
Nr. 11640/1 Prot  
Dt. 17.09.2022

Nr. 624/5 Prot.

Lezhë, më 08.09.2022

**Lënda : Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHE**

**Lezhë**

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHE**

**Lezhë**

Bazuar në ligjin Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2 gërma "b", në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 13, pika 2, neni 15, neni 16, neni 24, pika 2, neni 54, gërma "k", neni 55, pika 2 dhe 6, në ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social", neni 15, neni 16, neni 47, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 03.07.2019 "Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët" **konfirmoj bazueshmërinë ligjore** të vendimit nr. 97, datë 29.08.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për Vitin 2022".

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**

